



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:222477

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05660755

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.../...

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrjen të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit S.... M..... për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme sipas aktakuzës PP/II nr. 2111/22 të datës 17.10.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë në prezencë të Prokurores së Shtetit Ardiana Veseli të pandehurit S.... M....., 22.04.2024 bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

S.... M..... i lindur me, në Pejë me vendbanim në fsh. N....., nga i babai B....., e nëna H....., e gjinisë N....., ka të kryer shkollën mesme, me profesion punëtor teknik, martuar dy fëmijë, me gjendje të mesme ekonomike, i identifikuar, në bazë të letërnjoftimit me nr., i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datën në fsh. N..... K. P....., pikërisht në shtëpinë e tij, siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm me shkëmbim të kompensimit, e me qëllim që të shmang pagesën për shërbime të furnizimit me rrymë elektrike, në atë mënyrë që pas vizitës së bërë nga ana e komisionit të autorizuar të K.....-it, tek i pandehuri, kanë hasur në një sor të shkyçur nga distanca, mirëpo i kyçur direkt në rrjetin elektrik jashtë pikës matëse dhe me këtë veprim e ka anashkaluar një sorin elektrik, i cili e kishte për ta matur shpenzimin e kilovatëve të konsumuar, ku të gjeturat në vendin e ngjarjes tek i pandehuri janë përshkruar në procesverbal nr. të dt., ashtu që në mënyrë të pa autorizuar ka shpenzuar energjinë elektrike, me ç ‘rast sipas provave që ka prezantuar e dëmtuara K....., të njëjtës i ka shkaktuar humbje në vlerë prej 384.13 euro.

- me çka ka kryer vepër penale vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 7, 17, 38, 39, 46, 47, 49, 53, 69, 70, 71, 72, 314 par 1 të KPRK-së dhe nenit 7, 8, 9 dhe 364 të KPPRK- së, të pandehurit S.... M..... i shqipton:

DËNIM TË KUSHTËZUAR ME BURG

Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbaj në rast se i njëjti në afat prej 1 (një) vite nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumë prej 40,00 € në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Detyrohet i pandehuri S.... M..... që të dëmtuarës K..... sh.a me seli në P..... Dega në P..... në afat prej 90 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykitimit t'ia kompensoj shumën prej 384.13 euro ne kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme me datën 17.10.2022 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr. 2111/2022 ndaj të akuzuarit S.... M..... për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës gjykata në pajtim me nenin 241 par. 1 të KPPRK-se e ka udhëzuar të pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaroi për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Pasi i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta e leximit të aktakuzës gjykata është bindur se i pandehuri i ka kuptuar aktakuzat dhe nuk kanë nevojë për sqarime shtesë. Me pas gjykata e ka njoftuar te pandehurin për pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë.

I pandehuri është deklaruar fajtor për veprën penale për te cilën akuzohet duke shtuar se është e vërtetë që e kam kryer këtë vepër dhe premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të tilla.

Në vlerësimin e pranimit te fajësisë nga ana e te pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit të Shtetit e cila ka deklaruar se: sa i përket fajësisë nga ana te pandehurit se ky pranim është bërë në mënyrë vullnetare dhe ka mbështetje në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës andaj gjykatës i propozoj që të pranoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 244 i KPPRK-së, si dhe janë vërtetuar faktet nga neni 242 par. 6 të KPPRK-se, ndërsa aktakuza mbështet në këto prova siç janë: kallëzimin penal të “K.....”-it me Nr. C.../D...-.... i datës procesverbalet e “K.....”-it me nr. të dt., Fatura nga K..... mbi llogaritjen e dëmit të shkaktuar më nr. D..... të dt., si dhe foto-dokumentacioni me shkresat e tjera të lëndës, andaj ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili mbështet në provat, në bazë të së cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata mori pranimin e fajësisë, keqe ardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi nën mbikëqyrjen e shërbimit sprovës në Pejë, duke i tërhequr e vërejtjen me kërcënimin e dënimit mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e ka obliguar të pandehurin S.... M..... që në afat prej 90 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit t’ia kompensoj të dëmtuarës K..... shumën prej 384,13 € duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 51 par.1 dhe 2 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet për paushall gjyqësor në shumë prej 20,00 €, e duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj dhe 20,00 € për taksen për programin për kompensimin e viktimave të krimit,

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2022:222477, 07.05.2024**

Bashkëpunëtorja profesionale

Edona Berisha Kastrati

G j y q t a r i

Musë POVATAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.